



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
BURGJEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA  
DISKRIMINIMI



100 Vjet Pavarësi

Nr. 7571/12 Prot, datë 31.12.2012

Nr. 519 Prot, datë 20.12.2012

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) (të quajtura në vijim “Palë”)

*Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;*

*Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve;*

*Duke konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, si dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve pa diskriminim;

*Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandum;

*Duke u mbështetur* në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar;

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “*Memorandumi*”).

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim ndjekjen, kujdesjen dhe garantimin e një mbrojtje efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin të personave të dënuar apo që janë të paraburgosur, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe legjislacionit në fuqi.

## **Neni 2**

### **Format e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi i ndërsjelltë realizohet nëpërmjet formave:

1. Nxitjes dhe marrjes së masave mbi sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin për çështjet e mosdiskriminimit, për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme, duke përfshirë këtu vendosjen e posterave, shpërndarjen e informacioneve të ndryshme të shkruara në ambientet e ekzekutimit të vendimeve penale;
2. Nxitjes e kujdesjes për realizimin e bashkërendimit të veprimtarisë së institucioneve, në drejtim të hartimit dhe zbatimit të masave e politikave të posaçme për të garantuar që ekzekutimi i dënimit me burgim të bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe që trajtimi i tyre të bëhet pa diskriminim;
3. Garantimit të të drejtës për të paraqitur ankesë për diskriminim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke vendosur një kuti postare në çdo institucion të vuajtjes së dënimit penal;
4. Bashkërendimit në dhënien e informacionit lidhur me ankesat e paraqitura nga subjektet e ligjit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo përcjelljen te Komisioneri të informacioneve për shkelje të ligjit "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", si dhe për çdo çështje që lidhet me diskriminimin;
5. Bashkërendimit në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë;
6. Mbështetjes për përgatitjen profesionale, nëpërmjet trajnimeve, seminareve, aftësimin e specializimit të punonjësve të administratës së DPB-së për çështjet e diskriminimi;
7. Marrjes së masave për evidentimin dhe parandalimin e diskriminimit apo çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin edhe në strukturat e DPB-së;
8. Shkëmbimin e përbashkët të statistikave që kanë për bazë numrin e rasteve të raportuara për çështjet e diskriminimit, apo të statistikave të tjera që kanë lidhje me diskriminimin, me qëllim analizimin e tyre për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e mbrojtjes në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe garantimin e barazisë para ligjit;

9. Garantimit sipas legjislacionit në fuqi, për ofrimin e shërbimeve që lidhen me veprimtarinë e DPB-së dhe të çdo institucioni të ekzekutimi të vendimeve penale, bazuar në parimin e barazisë dhe pa diskriminim;
10. Bashkëpunimit në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive, si dhe mbështetjes për realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;
11. Bashkëpunimit edhe nëpërmjet formave të tjera për të cilat palët mund të bien dakort në të ardhmen.

### **Neni 3**

#### **Komunikimi i Palëve**

1. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore, me përjashtim të rasteve urgjente ku forma e komunikimit mund të jetë nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar
2. Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Memorandumit të Bashkëpunimit.
3. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
4. Me anë të përfaqësuesve të dyja Palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

### **Neni 4**

#### **Ndryshimi i memorandumit**

1. Ndryshimet në përmbajtjen e memorandumit bëhen me vullnetin e palëve.
2. Paraqitja e propozimeve për ndryshime në përmbajtjen e memorandumit bëhet me shkrim në rrugë zyrtare, ku përcaktohet edhe afati kohor i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara.

**Neni 5**  
**Dispozita të Fundit**

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet pa afat të caktuar.
2. Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e memorandumit, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.
3. Në rast mosmarrëveshje të dyja Palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe mirëkuptimit.
4. Ky Memorandum Bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) për secilën palë.
5. Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Nënshkruar në Tiranë, më 20 / 12 / 2012.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E BURGJEVE**

**GAZMENT DIBRA**



\_\_\_\_\_

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

**IRMA BARAKU**



\_\_\_\_\_

**KOMISIONERE**